

PERSPEKTIVA TË REJA, Kukës

SWISSCONTACT, SHQIPËRI

Thirrje për bashkëpunim
në fushën e punësimit të të rinjve dhe angazhimit të biznesit

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

PROPOZIMET DUHET TË DORËZOHEN NË PËRPUTHJE ME UDHËZIMET E MËPOSHTME

Paketa e aplikimit do të dërgohet
deri më **3 Shkurt 2023**

1. Historiku i organizatës dhe informacion mbi projektin

Swisscontact është një organizatë e pavarur jo-fitimprurëse Zviceriane e dedikuar ndaj zhvillimit ndërkombëtar. Misioni i saj është të mbështesë zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik, social dhe ekologjik dhe japë kontribut efektiv në drejtim të qëndrueshmërisë dhe prosperitetit në ekonomitë në zhvillim. Organizata u themelua në vitin 1959 me iniciativë të sektorit privat zvicerian. Për shkak të fokusit të saj në sektorin privat, Swisscontact ka të gjithë mjetet dhe ekspertizën për t'u angazhuar në sektorin privat dhe për të shfrytëzuar fuqitë e sektorit privat: burimet, inovacionin dhe dinamikën. Në qasjen e saj ndaj zhvillimit, Swisscontact gjithashtu frymëzohet nga një mënyrë të menduari dhe punuari të sektorit privat, duke vepruar në një mënyrë dinamike, kreative dhe të orientuar ndaj tregut. Swisscontact është e përkushtuar ndaj parimeve të zhvillimit të tregut. Përmes qasjes së Zhvillimit Gjithpërfshirës të Sistemeve (Inclusive System Development - ISD), ajo mbështet zhvillimin e tregjeve lokale dhe krijon një mjedis lehtësues për zhvillimin ekonomik vendor, të drejtuar nga institucione publike, private dhe civile kompetente, të angazhuara dhe efektive - për të krijuar dhe përmirësuar mundësitë për personat e pafavorizuar, qofshin ata prodhues, punëtorë, apo konsumatorë. Në këtë mënyrë, Swisscontact lehtëson krijimin e vendeve të reja të punës dhe zgjeron tregjet që mallrat dhe shërbimet të jenë të mundësuar edhe për njerëz më të varfër dhe me të ardhura të ulëta. Në Shqipëri është themeluar një rrjet prej mbi 170 këshilluesish për punësueshmërinë dhe sipërmarrjet e vogla, përgjatë gjithë dekadës së fundit, duke zbatuar metodologjinë e certifikuar "Këshillimi drejt Punësimit dhe Sipërmarrjes (C4EE, Coaching for Employment and Entrepreneurship)", e cila është zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin e Luzern-ës. Falë kësaj metodologjie, më shumë se 12,000 të rinj të marginalizuar, gra, minoritete dhe emigrantë të kthyer, kanë gjetur punësim ose kanë filluar biznesin e tyre të vogël. Kjo metodologji është institucionalizuar në AKPA (Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë) – një partner i rëndësishëm shtetëror.

Shqipëria është vendi më pak i zhvilluar në Europë, me një prodhim bruto produktesh për frymë prej 5200 US\$/ person/ vit (i cili është 70% nën mesataren europiane). Kukësi është rajoni më i varfër ekonomikisht i vendit. Familjet shpenzojnë shumicën e të ardhurave të tyre për ushqim dhe nevoja thelbësore (mesatarisht 41% ve cila është gjithashtu më e larta në Europë), duke treguar se ata e kanë shumë të vështirë të nxjerrin muajin. Ka pak mundësi për formim profesional apo për të marrë një arsim më të lartë në rajon. Arritja mesimore është e ulët dhe madje edhe ata që arrijnë të fitojnë aftësi profesionale apo arsimohen, gjejnë shumë pak mundësi t'i vënë aftësitë e tyre në zbatim në një treg pune me pak mundësi për një punë legjitime dhe të qëndrueshme.

Projekti Perspektiva të Reja, synon të arrijë tre rezultate kryesore:

Rezultati 1: *Të kontribuojë në rritjen e qëndrueshmërisë së komuniteteve ndaj presioneve për të emigruar ilegalisht në Mbretërinë e Bashkuar.* Ne synojmë të lehtësojmë që të rinjtë dhe kryefamiljarët gradualisht të fitojnë një kuptueshmëri të saktë mbi realitetin e emigrantëve të Kukësit në Mbretërinë e Bashkuar (një kontroll realiteti) dhe si pasojë ndryshimin në perceptimin e kësaj kërkese.

Rezultati 2: *Përmirësimin e kushteve socio-ekonomike.* Ne synojmë të lehtësojmë që të rinjtë të kenë akses më të madh ndaj punësimit të orientuar nga tregu, si në kompanitë e vjetra dhe të reja të vogla ose mesme po ashtu dhe në bizneset e vogla që ata kanë ngritur me familjet ose miqtë duke i lejuar ata të fitojnë të ardhura të denja, të qëndrueshme dhe afatgjata. Ne gjithashtu

synojmë të krijojmë një mjedis biznesi më të arritshëm që i lejon SME-të ekzistuese të zgjerohen, SME-të e reja të zhvillohen dhe biznesin e vogël të lulëzojë.

Rezultati 3: *Rritja e besimit të komuniteteve dhe sektorit privat në qeverisjen vendore për të krijuar një mjedis të arritshëm për zhvillimin ekonomik lokal, dhe të nxisë në mënyrë aktive atë. Ne synojmë të lehtësojmë që qeverisja lokale të forcojë kuptueshmërinë e saj për çfarë ka të bëjë zhvillimi lokal ekonomik dhe se si mund të stimulohet; dhe të rrisë kapacitetet e tyre për të planifikuar zhvillimin ekonomik vendor në bashkinë e tyre dhe të marrim masat e duhura për të nxitur në mënyrë efektive sektorin privat dhe të krijojmë punësim të qëndrueshëm dhe mundësi të ardhurash për të rinjtë.*

Kjo thirrje për bashkëpunim relizohet në kuadër të veprimtarive për arritjen e Rezultatit të Dytë.

2. C4EE (Këshillimi drejt Punësimit dhe Sipërmarrjes) dhe qasja e këshillimit të Biznesit të Vogël

Projekti Perspektiva të Reja po kërkon organizata partnere me përvojë në punën me të rinjtë, zhvillimin e aftësive dhe punësimin e tyre në rajonin e Kukësit (duke përfshirë Kukësin, Hasin dhe Tropojën). Nepërmjet këtij projekti ne synojmë të rrisim në mënyrë të konsiderueshme numrin e të rinjve që punësohen, hapin biznesin e tyre të vogël, si rezultat i ndjekjes së një cikli trajnimi drejt punësimit, apo trajnimit në biznes, në praktika ose stazhe në punë, ose edhe si një përgjigje ndaj konkurseve vjetore të biznesit që do të fillojnë të organizohen me zyrat e punës, komunitetin e biznesit, institucionet mikrofinanciare, OJF-të dhe bashkitë.

Në kuadër të këtij projekti, OJF-ja lokale e interesuar, sapo të zgjidhet dhe angazhohet si një bashkëpunëtorë e Swisscontact, do të jetë përgjegjëse për zgjedhjen e këshilluesve / mentorëve dhe përfituesve të të dy metodologjive C4EE. Kriteret e përzgjedhjes për këshilluesve / mentorëve, apo edhe për pjesëmarrësit (të trajnuarit/ të këshilluarit) shpjegohen si vijon.

2.1 Objektivat:

Objektivat e bashkëpunimit janë si më poshtë:

1. Mobilizimi i burimeve dhe komuniteteve vendore në identifikimin e rasteve të të rinjve të interesuar, të rinjve pjesë e grupeve vulnerabel apo edhe të rinjve të rikthyer nga emigracioni dhe krijimi i grupeve për:
 - Ciklin e Këshillimit drejt Punësueshmërisë: Pjesë e grupit do të jenë 10-15 të rinj të cilët synojnë të ndryshojnë jetën e tyre nëpërmjet punësimit/vetpunësimit në përputhje me tregun e punës në kontekstin lokal.
 - Mentorimi i mikro-bizneseve, i grupeve prej 10-15 të rinjsh të cilët së fundmi kanë hapur dhe/ose janë pronarë të mikro-bizneseve.
2. Të organizojë me grupet e të rinjve, Ciklin e Këshillimit drejt Punësueshmërisë dhe/ose grupet e mentorimit të biznesit të vogël bazuar në metodologjinë e Këshillimit për Punësim dhe Sipërmarrje (C4EE) dhe/ose Mentorimit të Biznesit të Vogël.
3. Të kontrakttojë këshilluesë për punësueshmërinë dhe/ose mentorë për biznesin e vogël dhe të lehtësojë trajnimin e tyre nga Swisscontact, njëkohësisht të mundësojë zbatimin e metodologjisë C4EE me grupet e të rinjve target i këtij projekti.

4. Të lehtësojë procesin e (vetë) punësimit për pjesëmarrësit e cikleve të trajnimit; dhe/ose të lehtësojë sipërmarrësit të rinj në arritjen e rezultateve në bizneset e tyre të vogla.

2.2 Këshillimi drejt Punësimit dhe Sipërmarrjes

Swisscontact së bashku me Universitetin e Shkencave të Aplikuara dhe Arteve në Luzern, Zvicër, ka zhvilluar metodologjinë e Këshillimit për Punësim, i cili është zbatuar tashmë për 11 vite në Shqipëri. Ai u mundëson institucioneve, të ndërtojnë kapacitete për këshillim për të rinjtë e interesuar apo të rinjtë pjesë e grupeve në nevojë që e kanë të vështirë të integrohen në tregun e punës. Swisscontact së bashku me Universitetin e Luzern-ës do të kryejnë trajnime për këshilluesit e identifikuar nga vet OJF-të, të cilët do të certifikohen në fund të ciklit të këshillimit. Me përfundimin e trajnimit, këshilluesit do të mund të marrin një certifikatë të akredituar ndërkombëtarisht nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara dhe Arteve të Luzern-ës. Zgjedhja e këshilluesve kryhet në bazë të kriterëve të mëposhtme dhe janë nën përgjegjësinë e Organizatës Lokale Partnere.

Kriteret për zgjedhjen e këshilluesve¹:

Këshilluesi duhet të ketë:

1. Eksperiencë dhe përvojë pune në programe sociale dhe zhvillimore.
2. Përvojë pune në shërbimet dhe programet e punësimit.
3. Përvoja e punës në moderimin e grupeve përbën avantazh.
4. Njohuri të dinamikave të komuniteteve dhe grupeve vulnerabel, të rinjve, emigrantëve.
5. Përvoja të mëparshme në organizimin/moderimin e trajnimeve.
6. Të jetë i motivuar dhe i vendosur në dhënien e kontributeve në ndërtimin e një jetese të denjë në Kukës, Has dhe Tropojë.
7. Gadishmëri për të punuar dhe lëvizur në varësi të nevojave të projektit.
8. Diplomë universiteti.
9. Kuriozitet dhe fleksibilitet.
10. Ne preferojmë të kemi një grup të balancuar gjinor.

Kriteret për zgjedhjen e të rinjve që do të trajnohen²:

Pjesëmarrësit e grupeve të ciklit të këshillimit duhet të identifikohen sipas karakteristikave të mëposhtme:

1. Mosha: 16 – 35.
2. Individë të cilët janë të papunë (ose të punësuar me kohë të pjesshme) dhe të motivuar për të ndryshuar jetën e tyre.
3. Të kenë mundësi të mbulojnë shpenzime të vogla në lidhje me punësueshmërinë e tyre (apo Ciklin e Këshillimit)
4. Njerëz që banojnë dhe planifikojnë të ndërtojnë jetën e tyre në Kukës, Has dhe Tropojë.
5. Të jenë të aftë të lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën shqipe (të paktën në një nivel bazë).
6. Ne preferojmë të kemi një grup të balancuar gjinor.

¹Këshilluesi është një person që do të zgjidhet nga një OJF partnere që përmbush kriteret e përmendura. Ai/ ajo do të trajnohet nga trajnuesit e Swisscontact për metodologjinë e Këshillimit për Punësim dhe Sipërmarrje dhe do të shoqërojnë/ trajnojnë një grup maksimumi prej 15 të rinjsh në lidhje me (vetë) punësimin.

²Një i trajnuar është një person që do të zgjidhet nga OJF fituese që përmbush kriteret e përmendura. Ata janë pjesëmarrës të grupeve të ciklit të këshillimit, që me mbështetjen e këshilluesit do të udhëzohen/ trajnohen në lidhje me (vetë) punësimin.

2.3 Mentorimi i Biznesit të Vogël

Në thelb të kësaj qasjeje janë këshilluesit / mentorët e biznesit të vogël. Mentorët janë persona me përvojë në fushën e biznesit që i këshillojnë sipërmarrësit e vegjël në disa drejtime si: marketing/reklamim, shitje, financa, çështjet tatimore, lejet dhe rrjetin e biznesit. Ata kryejnë trajnime të vazhdueshme, por ç'është më e rëndësishmja, ata monitorojnë çdo muaj sipërmarrësit e bizneseve të vogla, ndjekin ecurinë e tyre dhe japin këshilla. Në disa raste e drejtojnë sipërmarrësin e vogël tek një biznes tjetër që ata njohin dhe që i ka zgjidhur në mënyrë efektive problemet me të cilat po përballen. Gjithashtu zhvillohen module e-learning (të mësuarit elektronik) për ta, të postuara dhe të arritshme në aplikacionin Mundesi Plot.

Kriteret për zgjedhjen e mentorëve³:

1. Të kenë aftësi shumë të mira komunikimi, të jenë dëgjues të mirë si dhe të aftë për të dhënë këshilla.
2. Përvojë e mëparshme në menaxhimin e një biznesi (të vogël).
3. Aftësi të mira në analizimin dhe udhëzimin e sipërmarrësve të rinj të bizneseve të vogla.
4. Eksperiencë në reklamimin/ shitjen e bizneseve të vogla.
5. Njohuri në lidhje me rreziqet potenciale të sipërmarrjeve të vogla.
6. Preferohet: njohuri në lidhje me legjislacionin fiskal të biznesit të vogël.
7. Njerëz që banojnë dhe janë të motivuar në dhënien e kontributit në ndërtimin e një jetese të denjë në Kukës, Has dhe Tropojë.
8. Kuriozitet dhe fleksibilitet.
9. Ne preferojmë të kemi një grup të balancuar gjinor.

Kriteret për perzgjedhjen e të rinjve sipërmarrës në miro-biznes:

1. Sipërmarrësit e rinj që janë vetëpunësuar; ose që po planifikojnë të hapin një mikro-biznes të ri ku të vetëpunësohen.
2. Të rinjtë e grupeve të dis-avantazhuara janë të mirëpritur.
3. Njerëz që banojnë dhe po planifikojnë të ndërtojnë jetën e tyre në Kukës, Has dhe Tropojë.
4. Ne preferojmë të kemi një grup të balancuar gjinor.

3. Kriteret e bashkëpunimit.

3.1 Organizatat që janë të interesuara të bashkëpunojnë, dhe që mund të aplikojnë për t'u përfshirë në partneritet.

Ne mirëpresim aplikime dhe shprehje interesi nga organizatat jo-qeveritare vendore të regjistruara dhe me një status aktiv, që mund të na sigurojnë një prani operationale në Kukës, Has dhe/ose Tropojë.

3.2 Kriteret e Bashkëpunimit: Cilat OJF / partnerë do të merren në konsideratë?

- OJF-të lokale të hapura ndaj bashkëpunimit në lehtësiumin e zhvillimit social-ekonomik dhe punësimit;

³Një këshillues është një person që do të zgjidhet nga NGO kërkues që përmbush kriteret e përmendura. Ai/ ajo do të trajnohet nga trajnerët e Swisscontact në lidhje me metodologjinë e këshillimit të Biznesit të vogël dhe do të drejtojnë/ këshillojnë grupin me një maksimum prej 15 sipërmarrësish të bizneseve të vogla..

- OJF-të lokale që janë të interesuara në adoptimin dhe institucionalizimin e qasjes C4EE dhe qasjes së Mentorimit të Biznesit të vogël si metodologjinë e tyre të qëndrueshme për punësueshmëri;
- OJF-të lokale që kanë ambiente të disponueshme për ciklin e këshillimit me të rinjtë në Kukës, Has, ose Tropojë;
- OJF-të lokale me një strukturë organizative dhe qeverisjeje të mirëthemeluara;
- OJF-të lokale me përvojë në planifikim, raportim dhe monitorim;
- OJF-të lokale me kapacitetet e duhura të burimeve njerëzore për caktimin dhe/ ose punësimin e këshilluesve / mentorëve për të zbatuar veprimtaritë e ciklit të këshillimit dhe mentorimit të biznesit të vogël;
- OJF-të lokale që shprehin gatishmërinë për të kontribuar, bashkëfinanciarisht në burime (financiare dhe në natyrë) ose për të bashkëfinancuar pjesërisht aktivitetet;
- OJF-të lokale të regjistruara në Autoritetin Tatimor (me një NIPT aktiv, regjistrim në RPP, system fiskalizimi funksional) në territorin e Shqipërisë dhe operojnë në Qarkun e Kukësit (Kukës, Has dhe Tropojë).

3.3 Kërkoheq që Organizatat partnere t'u përmbahen parimeve të mëposhtme:

- Sigurimi i barazisë gjinore.
- Inkurajimi i barazisë dhe përfshirjes sociale.
- Pajtueshmëri me standardet dhe rregullat ndërkombëtare të llogaridhënies në lidhje me projektin.
- Pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e Swisscontact dhe donatorit. (Kjo përfshin plan monitorimesh)
- Përputhshmëria me strategjinë e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) për punësimin e të rinjve.
- Përputhshmëria me standartet e mbrojtjes dhe të drejtat e njeriut.

4. Procesi i Aplikimit

- ❖ Organizatat e interesuara për të bashkëpunuar, mund të depozitojnë dokumentet si më poshtë:
 - Shtojca 1 – Shprehja e interesit për bashkëpunim / partneritet.
 - Shtojca 2 – Pyetësori i vet-vlerësimit.
 - Shtojca 3 – Jetëshkrimi (CV) e organizatës dhe personave të propozuar si këshillues / mentor.
- ❖ Formularët duhet të jenë të shkruar, **në gjuhën shqipe**, në bazë të formatit model (**Shtojca D**).
- ❖ Swisscontact Albania do të vlerësojë të gjitha shprehjet e interesit dhe do të përzgjedhë ato që përmbushin kriteret e bashkëpunimit / partneritetit.
- ❖ Aplikimet e papërfunduara nuk do të merren në konsideratë dhe do të kontaktohen vetëm aplikantët e përzgjedhur.
- ❖ Partnerët e interesuar duhet të depozitojnë aplikimin përpara datës **3 Shkurt 2023**.
- ❖ Projekti Perspektiva të Reja do të jetë i hapur për adresimin dhe përgjigjen e pyetjeve tuaja (ekskluzivisht nëpërmjet email-it) deri më **26 Janar 2023**.
- ❖ Njoftimi përfundimtar i OJF-ve partnere të përzgjedhura do të shpallet më 24 **Shkurt 2023**.

Infrastruktura /Mjediset:

Partnerët e interesuar duhet të mundësojnë individualisht infrastrukturën dhe vendet për zbatimin e projektit.

Mundësi për bashkëfinancim:

Do t'u jepet përparësi partnerëve të interesuar për bashkëpunim që kanë mundësi bashkëfinancimi për zbatimin e projektit/aktiviteteve.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit:

Marrëveshjet e bashkëpunimit do të nënshkruhen me OFJ-të e përzgjedhura. Draft marrëveshjet (dokumentet) do të ndahen me ju paraprakisht për rishikim përpara finalizimit të tyre.

Buxheti:

Zërat e buxhetit dhe propozimet në lidhje me to do të negociohen individualisht me partnerët përpara finalizimit të marrëveshjeve. Taksat dhe tarifat zbatohen në përputhje me praktikën e Swisscontact nga përvoja të ngjashme në zbatimin e kësaj metodologjie.

Komente/ Pyetje:

Për çdo pyetje ose koment, mos hezitoni të na kontaktoni drejtpërdrejtë në:

npkpartners@swisscontact.org

16 Janar 2023

Perspektiva të Reja Kukës
Stafi i Projektit